

GALLUP®

Balkan Monitor

Insights and Perceptions: Voices of the Balkans

in partnership with the

European Fund for the Balkans

2008 Përmbledhje e rezultateve

• Njohuri e perceptime: Zëra nga Ballkani	4
• Rezultatet kryesore	6
• Vështrimi mbi vendin	8
• Të kënaqurit nga jeta dhe zhvillimi i vendit	11
• Qëndrimet ndaj BE	14
• Të kënaqurit dhe besimi në institucionet e rajonit	18
• Qeverisja e mirë dhe korrupsioni	21
• Migracioni dhe lëvizshmëria	24
• Sfidat e Ballkanit: Kosova, stabiliteti i ardhshëm i rajonit dhe ICTY	27
• Përfundime	31
• Rreth Fondit	33
• Rreth Gallupit	34

Njohuri e perceptime: Zëra nga Ballkani

Ballkani Perëndimor është një rajon vazhdimisht në ndryshim që shpesh e gjen veten në qendër të vëmendjes. Ndonse zhvillimi i tij është shënuar nga rritja dinamike, atje ka gjithashtu trashëgimi të rënda të konflikteve dhe krizave të shumta. Shpallja e pavarësisë së Kosovës, arrestimi në Serbi i ish-kreut serbo-boshnjak dhe të dyshuarit kryesor për krimet e luftës Radovan Karaxhiç dhe tensionet politike në rritje në Bosnje dhe Hercegovinë janë vetëm disa nga shumë zhvillime që kanë ndodhur së fundmi në rajon.

Megjithatë, pavarësisht nga interesi i lartë për Ballkanin, nuk dihet shumë mbi popujt e tij, shpresat, mendimet e pikpamjet e tyre rreth ndryshimeve që ndodhin rreth tyre. Gazetarët shpesh duhet të shkruajnë rreth individëve dhe historive të tyre ose të mbështeten në provat anekdotike, për shkak të mungesës së studimit të bazuar në prova që e kanë origjinën nga Ballkani Perëndimor; nga ana tjetër, vendim-marrësit e përqëndrojnë vëmendjen e tyre në nivelet politike e institucionale.

Sidoqoftë, me qëllim që administratat të jenë efektive, duhet të ekziston një lidhje e ngushtë midis autoriteteve dhe popullit që ato përfaqësojnë. Në këtë rast, kjo kërkon nevojën për një mirëkuptim më të madh të perceptimeve dhe sjelljeve të popujve në rajon. Për të përmbushur këtë kërkesë, Gallup ka nisur një projekt shumë-vjeçar, Monitori i Ballkanit (shih www.balkan-monitor.eu), që vëzhgon ndryshimet në atë se si aspekte të ndryshme të jetës janë perceptuar në Ballkanin Perëndimor në kohë.

Monitori ka për qëllim të japë të dhëna të sjelljes së ekonomisë për t'ju intervistuar pyetjeve kyçe të tilla si:

- Si e vlerësojnë popujt e rajonit situatën e tyre ekonomike dhe standardet e tyre të

jetesës?

- Cilat janë pikëpamjet e tyre mbi zhvillimet në vendet përkatëse të tyre?
- Ç'farë ndjejnë njerëzit e rajonit rreth fqinjëve të tyre?
- Deri në ç'farë shkalle shtetasit u besojnë institucioneve të tyre vendore?
- A mendojnë njerëzit se në vendet e tyre ka mundësi të mjaftueshme për punësim?

Rajoni ka hyrë gjithashtu në një kurs të qëndrueshëm drejt një integrimi të plotë në BE dhe, deri tani, 2008 ka qenë një vit i rëndësishëm lidhur me këtë. Të gjitha vendet e rajonit, me përjashtim të Kosovës, kanë nënshkruar tashmë Marrëveshjet e Para-pranimit (Marrëveshjet e Stabilizimit dhe Shoqërimit, SAA) si dhe marrëveshjet e lehtësimit të vizave. Megjithatë, përparimi drejt anëtarësimit në BE nuk është i barabartë. Ndonse Kroacia pritet të përfundojë negociatat e anëtarësimit deri në fund të 2009 dhe Serbia ka të ngjarë të marrë statusin e kandidatit zyrtar të BE deri atëhere, situata lidhur me kandidaten e BE, Maqedoninë, ka ngecur dhe mungesa e përparimit në Bosnje dhe Herzegovinë është kritikuar rëndë.

Bazuar në përparimin paksa të pabarabartë drejt integritit të Ballkanit në BE, ngrihen të

tjera çështje:

- Sa e fortë është mbështetja për anëtarësimin në BE në rajon?
- A ndejnë njerëzit e rajonit se janë të dëshëruar dhe të mirëpritur nga Komisioni Evropian dhe shtetasit e BE?
- Ç'farë date shohin ata si realiste që vendet përkatëse të tyre të bashkohen me BE?

Duke synuar t'u përgjigjet shumë pyetjeve në një larmi të gjerë temash, Monitori i Ballkanit u krye në bashkëpunim me Fondin Evropian për Ballkanin (SFB), një nismë e përbashkët

e Fondacionit Robert Bosh, Compagnia di San Paolo, Fondacionit Erste dhe Fondacionit Mbreti Boduin, që mbështesin projektet që kanë për qëllim prurjen e Ballkanit Perëndimor më pranë BE.

Sondazhi është përfaqësues i popullsisë së rritur (15 vjeç e lart) në vendet e Ballkanit Perëndimor. Për çdo vend, së paku 1,000 intervista një me një u zhvilluan në shtator e tetor 2008, secila nga të cilat zgjati për gati një orë. Kufiri i gabimit për sondazhin është +/- 3%.

Rezultatet kryesore

KËNAQËSIA NGA JETA DHE ZHVILLIMI I VENDIT

- Dy vendet që u bënë të pavaruara më së fundmi, Kosova dhe Mali i Zi, ishin të vetmet vende ku një shumicë të intervistuarish (62% dhe 59% respektivisht) ishin optimistë për të ardhmen e vendit të tyre. Pesimizmi ishte i përhapur në Kroaci (ku 64% e shihnin vendin e tyre se po shkonte në drejtim të gabuar) dhe në Bosnje dhe Hercegovinë (61%).
- Me përjashtim të Kroacisë dhe Kosovës, më shumë se gjysma e njerëzve në rajon ishin të kënaqur me standardet e tyre jetësore. Përafërsisht dy të tretat e të intervistuarve në Serbi (62%) dhe në Maqedoni (64%) nuk ishin të kënaqur me standardet e tyre jetësore.

QËNDRIMI NDAJ BE

- Kosova dhe Shqipëria e shihnin BE në mënyrë të veçantë pozitivisht; shtetasit në Kroaci dhe Bosnje dhe Hercegovinë, sidomos në njësinë serbe, ishin më negativët. Në Shqipëri, 83% e të intervistuarve besonin se anëtarësimi në BE i vendit të tyre do të ishte një gjë e mirë. Kosovarët, megjithatë, i besonin NATO-s edhe më shumë se institucioneve të BE.
- Ndërsa kishte më shumë kroatë që besonin se ishte një gjë e mirë për vendin e tyre të bëhej një anëtar i BE se sa ata që nuk e besonin këtë, shumica relative mbajti një qëndrim të mesëm: duke rënë dakord me pohimin se nuk ishte as

mirë, as keq. Pothuajse gjysma (47%) e kroatëve që ishin të gatshëm të gjykonin përshtypjen e vendit besonin se patriotët e tyre po mbështesnin anëtarësimin në BE; pak mbi gjysma (53%) besonin se shumica ishte kundër bashkimit me BE.

- Dy vendet kandidatë zyrtarë, Kroacia dhe Maqedonia ishin të vetmet ku shumica ndjehej e mirëinformuar mbi BE.

PËRMBUSHJA E NEVOJAVE DHE BESIMI NË INSTITUCIONET E RAJONIT

- Kosova (53%) dhe Mali i Zi (55%) ishin të vetmet territore ku një shumicë të intervistuarish flisnin pozitivisht rreth ecurisë së qeverisë së tyre. Në krahasim, pakënaqësia ishte më e madhe në Bosnje dhe Hercegovinë, ku 67% dhanë një vlerësim negativ.
- Njerëzit në rajon nuk tregojnë shumë besim në organizmat politike të vendeve të tyre. Me të vërtetë, institucionet politike kombëtare morën vetëm një renditje të ulët në të mesme; kisha (dhe organizma të tjerë fetarë) vinin të parat në pothuajse të gjitha vendet.
- Kosova dhe Shqipëria ishin përjashtime: atje në vend të organizatave fetare, NATO u tha se ishte më e besueshmja.

QEVERISJA E MIRË DHE KORRUPSIONI

- Me përjashtim të Shqipërisë, jo më shumë

se një në dhjetë të intervistuar nga Ballkani raportuan një rast që mund të interpretohej si një nevojë për t'i dhënë rufshet një nëpunësi shteti në një vit përpara vëzhgimit. Në Shqipëri, kjo shifër arrinte në 32%.

- Maqedonia ishte i vetmi vend ku ata që ishin dakord se vendi i tyre po bënte mjaft për të luftuar krimin e organizuar ishin më tepër se ata që ndjenin të kundërtën (49% ndaj 35%).

MIGRACIONI DHE LËVIZSHMËRIA

- Tre të katërtat (73%) e të intervistuarve në Kosovë mendonin se kishte mundësi më të mira jashtë.
- Përafërsisht dy të tretat e shqiptarëve (69%) dhe të kosovarëve (66%) ndjenin se njerëzit që shkonin të jetonin në një vend tjetër ishin “një ndihmë e madhe për vendin”.
- Në mënyrë ideale, përafërsisht 20% e të intervistuarve nga secili vend thanë se do të lëviznin në një vend tjetër, përjashtimi i vetëm qe Kroacia ku vetëm 7% duan të lëvizin përkohësisht apo përgjithmonë.
- Mali i Zi dhe Kroacia ishin të vetmet shtete ku shumica e njerëzve besonin se vendi i tyre ofron mundësi të mjaftueshme.

SFIDA BALLKANIKE: KOSOVA, STABILITETI I ARDHSHËM I RAJONIT DHE ICTY

- Me përjashtim të Kosovës, Shqipërisë dhe Kroacisë, shumica relative e të intervistuarve kishin frikë se pavarësia e Kosovës

do të kishte një ndikim negativ në stabilitetin në rajon.

- Vetëm 17% e serbëve të Kosovës thanë se ishte e mundur të jetonin paqësisht me shqiptarët e Kosovës; nga këta të fundit, shtatë në dhjetë (72%) e ndjenin bashkëekzistencën paqësore frutëdhënëse.
- Gjashtë në dhjetë (61%) e banorëve serbë thanë se pavarësia e Kosovës nuk do të pranohej kurrë; një e katërta mendonte se kjo do të ishte e mundur brenda dhjetë vjetësh.
- Një shumicë e qartë anembanë të gjitha vendeve mendonin se e ardhmja e rajonit do të ishte paqësore. Një në katër serbë dhe maqedonas (22% dhe 29% respektivisht), megjithatë ndjenin se mund të kishte një tjetër luftë në rajon.
- Pothuajse gjysma e serbëve të intervistuar mendonin se Radovan Karaxhiç ishte i pafajshëm për krimet që ai qe akuzuar (47%); nga ana tjetër, 45% besonin se arrestimi i tij ishte i mirë për të ardhmen e Serbisë.
- Me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës, një e treta apo më pak e njerëzve në çdo vend, besonin se procedimet e ICTY ishin të paanëshme dhe përfundimet, të hapura.

Vështrimi mbi vendin

SHQIPËRIA: MBËSHTETËSE NDAJ BE, E KËNAQUR TË LËRË VENDIN

Shqiptarët besojnë se vendi i tyre do të mirëpritet nga BE si një vend i ri anëtar. Bashkimi Evropian, në fakt, është parë të ketë një ndikim të fortë: shumica e shqiptarëve besonin në institucionet e BE dhe 83% besonin se anëtarësimi në BE do të ishte i mirë për Shqipërinë. Rryshfeti ndaj nëpunësve qeveritarë dhe punonjësve civilë u raportua të ishte nga më të lartët në rajon me një të tretën e të intervistuarve që u ishte dashur të paguanin një rryshfet në vitin përpara vëzhgimit. Vetëm 29% besonin se qeveria po bënte diçka për këtë. Shqiptarët dukej të ishin populli më i lëvizshëm i rajonit, me mbi dy të pestat e të intervistuarve që pohonin se kishin një anëtar të familjes që punonte apo studjonte jashtë. Mbi një e treta e shqiptarëve thanë se donin të iknin nga vendi.

BOSNJE DHE HERZEGOVINA: TË NDJERËT TË PAKËNAQUR

Shumica e boshnjakëve ishin të pakënaqur me gjendjen aktuale ekonomike (87% ishin të pakënaqur) dhe shprehën pak shpresë për ndonjë përmirësim në të ardhmen. (Dy të tretet e të intervistuarve në Federatë besonin se kushtet ekonomike po bëheshin më keq, ndërsa më pak se gjysma, 44%, mendojnë po kështu në Republika Srpska, me 31% që shohin tashmë shenja përmirësimi). Qeveria shihej se shkonte shumë keq (me 67% të normës negative, më e keqja në rajon: 70% në Federatë dhe 56% në Republika Srpska) dhe që ishte e paefektshme në luftën e saj kundër krimit të organizuar. Nga ata që ju përgjigjën pyetjes, 45% e të intervistuarve në Federatë kishin pak apo

aspak besim në institucionet europiane: në njësinë serbe 77% e të intervistuarve dhanë të njëjtën përgjigje. Republika Srpska raportoi gjithashtu raportin më të madh të njerëzve në rajon, (48%), që ndjenin se shtetasit e BE nuk i duan ata të bashkohen me Bashkimin.

KROACIA: TË KËNAQUR ME JETËN PERSONALE, TË PAKËNAQUR ME DREJTIMIN E VENDIT

Ndërsa të intervistuarit kroatë ishin të kënaqur me jetën (72%), ata kishin një opinion shumë negativ rreth të ardhmes ekonomike të vendit të tyre (61% mendonin se ajo po bëhet më keq). Kjo qe pasqyruar gjithashtu në pakënaqësinë ndaj qeverisë dhe veprimet e saj kundër krimit të organizuar (78% ishin të pakënaqur). Megjithatë, të intervistuarit kroatë shihnin mundësi të mira në vendin e tyre dhe vetëm një përqindje e ulët (7%) ndjeheshin të detyruar të iknin për arsye ekonomike. Shumica ndiheshin të mirëinformuar lidhur me BE, (54%), dhe ishin më optimistët për datën e pranimit: mesatarisht, kroatët prisnin të bashkoheshin me BE në 2013. Kishte më shumë kroatë që besonin se anëtarësimi në BE ishte mirë për vendin, (29%), se ata që e gjykonin këtë të keqe (26%). Megjithatë, me datën e pranimit që afrohej, shumica relative (38%) nuk mbanin anë (duke thënë se nuk ishte as mirë, as keq). Kur të intervistuarit u pyetën nëse mendonin se shumica e bashkë-shtetasve të tyre e mbështesnin apo ishin kundër anëtarësimit në BE, 39% ndjenin se e mbështesnin hyrjen në BE, ndërsa 45% mendonin se do të kishte kundërshtime.

KOSOVA: OPTIMISTË RRETH JETËS DHE BE, POR JO RRETH EKONOMISË

Të intervistuarit në Kosovë ishin optimistë rreth jetës së tyre dhe me plot shpresë për të ardhmen e përgjithëshme dhe ekonomike të vendit (59% ishin pozitivë). Gjendja ekonomike e tanishme shihej me një dritë shumë më të errët, gjë që shpjegonte se pse mbi 70% e të intervistuarve shihnin mundësi më të mëdha jashtë vendit dhe përqindja e lartë e atyre që kishin një anëtar të familjes jashtë. Të intervistuarit e Kosovës ishin përgjithësisht optimistë rreth shpresave për paqen e ardhshme në rajon. Ndërsa 72% e shqiptarëve të Kosovës mendonin se një bashkë-ekzistencë paqësore me serbët e Kosovës ishte e mundur, vetëm 17% e serbëve të Kosovës ishin të bindur për një mundësi të tillë. Më pak se gjysma (45%) e shqiptarëve të Kosovës ishin dakord se udhëheqja shqiptare e Kosovës duhej të bënte gjithshka për të mbrojtur serbët të jetonin në Kosovë: ndërsa 47% nuk ishin dakord. Vetëm më pak se dy të tretat (63%) e të intervistuarve në Kosovë kishin “shumë” besim në NATO, ndërsa më pak se gjysma (43%) kishin “shumë” besim në institucionet e BE.

MAQEDONIA: E DËSHPËRUAR RRETH JETËS DHE E TREMBUR NGA NJË KONFLIKT I ARMATOSUR

Shumë të intervistuar maqedonas ishin të pakënaqur si me jetën e tyre (në 46% , kjo ishte renditja më e ulët në rajon) dhe me standardet e jetesës. Një e treta, megjithatë, ndjenin se ekonomia po përmirësohej. Të intervistuarit dënonin sjelljen e korruptuar dhe ishin relativisht të kënaqur me përpjekjet e qeverisë në luftën kundër krimit të organizuar (49% të kënaqur). Tre në dhjetë maqedonas ndjenin se

kishte të ngjarë për një tjetër konflikt të armatosur në rajon (29%). Ndërsa 70% e shqiptarëve në Maqedoni besonin se Marrëveshja e Ohrit jepte një zgjidhje afat-gjatë për problemet etnike të Maqedonisë, vetëm 30% e maqedonasve ishin dakord. Sipas 69% të shqiptarëve maqedonas, Maqedonia duhet të bashkohet me NATO-n dhe BE edhe në qoftë se kjo do të thotë të ndryshojë emrin zyrtar të vendit, një mendim që mbështetet vetëm nga 3% e maqedonasve (shumica e popullsisë). Shumica e të dy komuniteteve ishte dakord se anëtarësimi i vendit në BE do të ishte një gjë e mirë (87% e shqiptarëve dhe 57% e maqedonasve).

MALI I ZI: NJË NDJESI E PËRGJITHËSHME ARRITJESH DHE PRANUESHMËRIE

Të intervistuarit në Malin e Zi ishin të kënaqur me jetën e tyre (71%) dhe paksa pozitivë rreth ekonomisë dhe zhvillimit të saj të ardhshëm (49%). Besimi te qeveria ishte i lartë (63%). Me mundësitë që shihen si të kënaqëshme, ka pak dëshirë për të lënë vendin. Të intervistuarit malazezë kishin pikëpamje relativisht të shkurtra rreth pranueshmërisë së praktikave të dyshimta. Lidhur me BE, popullsia ndjehej paksa e keqinformuar (60%).

SERBIA: E PAKËNAQUR NGA JETA, E NDARË RRETH SË ARDHMES

Të intervistuarit serbë treguan një pakënaqësi të lartë me jetën (42%). Të intervistuarit ishin të ndarë në parashikimin e tyre të së ardhmes, me 47% që besonin se gjërat në përgjithësi po shkonin në drejtimin e gabuar dhe 41% që mendonin ndryshe. Rreth gjysma e të intervistuarve (46%) kishin “shumë” ose “disi” besim në qeverinë serbe. Megjithatë, në të njëjtën kohë, shumica (58%) thanë se qeveria nuk

ishte në gjendje të luftonte efektivisht krimin e organizuar. Tre të pestat e të intervistuarve mendonin se pavarësia e Kosovës nuk do të pranohej kurrë nga Serbia dhe një e pesta frikësohej për një tjetër konflikt të armatosur në rajon, proporcioni më i lartë në rajon pas atij në

Maqedoni. Radovan Karaxhiç gjykohej të ishte i pafajshëm nga gati gjysma e të intervistuarve. Pavarësisht nga kjo, rreth po aq (49%) ishin dakord me deklarinimin se arrestimi i tij e lejoi Serbinë të përqëndrohet në të ardhmen.

Të kënaqurit nga jeta dhe zhvillimi i vendit

Historia e kohërave të fundit e rajonit të Ballkanit Perëndimor është shënuar nga konflikte dhe tensione etnike. Duke vështruar përpara është kësaj thelbësore për të parë se si banorët e shohin jetën e tyre sot, sa të kënaqur janë me gjendjen e tyre dhe si e mendojnë të ardhmen.


Në më pak se 15 vjet pas luftës së 1992-1995, Monitori i Ballkanit tregon një tablo paksa të coptuar të Ballkanit Perëndimor:

- Ndonse shumica e shtetasve janë të kënaqur me jetën e tyre në përgjithësi, shumë janë të pakënaqur me situatën ekonomike dhe perspektivat për të ardhmen;
- Ndërsa ka disa 'shtete të rinj' tejet optimistë, Mali i Zi dhe Kosova për shembull, të tjerë janë më të zhgënjyer, veçanërisht Bosnja, Serbia dhe Maqedonia;
- Ka një ndjenjë të përgjithëshme kënaqësie anembanë Ballkanit, me të intervistuarit malazezë e kosovarë, që shfaqen më optimistët rreth së ardhmes.

intervistuarve thanë se ishin së paku mjaft të kënaqur me jetën e tyre. Në Kroaci, përafërsisht një në pesë vetë këmbëngulën se ishin shumë të kënaqur.

Pakënaqësia me jetën në përgjithësi ishte veçanërisht e lartë në Serbi e Maqedoni, ku më pak se gjashtë në dhjetë të intervistuar ishin të kënaqur me jetën e tyre dhe më shumë se katër në dhjetë, jo. Pesëmbëdhjetë përqind

TË KËNAQURIT ME JETËN NË BALLKANIN PERËNDIMOR



Në tërësi, sa të kënaqur jeni ju me jetën tuaj përgjithësisht?

NJË SHUMICË NË BALLKAN JANË TË KËNAQUR ME JETËN E TYRE

Anembanë vendeve të Ballkanit Perëndimor, një shumicë të intervistuarish thanë se ishin përgjithësisht të kënaqur me jetën e tyre. Këto ndjenja ishin veçanërisht të larta në Kroaci, Mal të Zi dhe Kosovë: rreth tre të katërtat e të

e shtetasve në të dy vendet thanë madje se nuk ishin fare të kënaqur.

ZYMTIA E PËRGJITHËSHME RRETH EKONOMISË TË BALLKANIT PERËNDIMOR


Anëmbanë Ballkanit Perëndimor, një shumicë e madhe të intervistuarish e konsideronin gjendjen ekonomike në vendin e tyre të ishte e keqe. Njerëzit në Bosnje dhe Hercegovinë ishin më të zymtët pasi gati nëntë në 10 të intervistuar mendonin se ekonomia e vendit të tyre nuk shkonte mirë (87%). Në Kroaci e Serbi, tetë në 10 të intervistuar kishin këtë pikpamje. Tre të katërtat e të intervistuarve në Maqedoni thanë të njëjtën gjë për ekonominë e vendit të tyre, siç bënë shtatë në 10 shqiptarë dhe dy të tretat e të intervistuarve në Kosovë. Të intervistuarit e Malit të Zi dhanë vlerësimin më pozitiv rreth ekonomisë së vendit të tyre: ndërsa gjysma e të intervistuarve mendonin se kushtet ekonomike nuk ishin të mira (53%), një e treta ishin pozitivë rreth situatës së tanishme ekonomike (34%).

Shumica e njerëzve ishin negativë rreth standardeve të tyre personale të jetesës. Me përjashtim të Kosovës dhe Kroacisë, më tepër se gjysma e të intervistuarve thanë se ishin të pakënaqur me standardet e tyre të jetesës. Niveli i pakënaqësisë ishte veçanërisht i lartë në Serbi dhe Maqedoni, ku afërsisht dy të tretat e të intervistuarve ishin jo të lumtur me standardet e tyre jetësore dhe vetëm një e treta ishin të kënaqur. Në Kosovë, një shumicë e të intervistuarve ishin të kënaqur me standardet e tyre të jetesës (59%); në Kroaci, një numër i barabartë ishin të kënaqur e të pakënaqur (të dy 49%).

E ARDHMJJA: NJË PËRZJERJE E OPTIMIZIMIT DHE ZHGËNJIMIT

Ndërsa kosovarët e malazezët ishin të

EVOLUCIONI I KUSHTEVE EKONOMIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR



Tani, mendoni ju se kushtet ekonomike në këtë vend, si të tëra, po bëhen më mirë apo më keq?

intervistuarit që më shpesh parashikonin një të ardhme të ndritur për vendin e tyre, në Kroaci dhe Bosnje dhe Hercegovinë kishte pesimizëm. Me të vërtetë, anëmbanë vendeve të Ballkanit Perëndimor, vetëm Kosova (62%) dhe Mali i Zi (59%) kishin një shumicë të intervistuarisht që mendonin se gjërat po shkonin në drejtimin e duhur. Në vendet e tjera, shumica shqetësohej rreth të ardhmes së vendit të tyre. Pesimizmi ishte veçanërisht i përhapur në Kroaci (64%) dhe në Bosnje dhe Hercegovinë (61%), ku afërsisht gjashtë në 10 të intervistuar mendonin se vendi i tyre ishte nisur në drejtim të gabuar dhe më pak se tre në 10 të intervistuar kishin një pikëpamje të kundërt.

Kishte përpjestime të larta të të intervistuarve që prisnin se standardet e tyre jetësore do të përmirësoheshin në Kosovë (59%) dhe Malin e Zi (47%), ndërsa Kroacia dhe Bosnje dhe Hercegovina kishin pjesën më të shumtë të të intervistuarve që mendonin të kundërtën (të dyja 44%). Megjithatë, nuk qe e gjitha e zymtë në Bosnje dhe Hercegovinë, pasi ishte afërsisht e njëjta pjesë e të intervistuarve që mendonin se standardet e tyre jetësore do të përmirësoheshin, ashtu si në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Maqedoni

e Serbi (afërsisht një e treta në secilën). Qëndrimet ishin tepër të ndara rreth zhvillimit të ekonomive. Vetëm kosovarët (59%) kishin një shumicë që mendonte se kushtet ekonomike në vendin e tyre do të përmirësoheshin, ndërsa Kroacia (61%) dhe BiH (58%) ishin të vetmet vende ku një shumicë të intervistuarish

ishin pesimistë rreth së ardhmes. Në Serbi, Shqipëri dhe Maqedoni, të intervistuarit që ishin të shqetësuar (afërsisht 45%) i tejkalonin ata që kishin besim (rreth një e treta). Pjesët e mbetura të të intervistuarve, afërsisht një në pesë, mendonin se kushtet ekonomike do të mbeteshin të njëjta.

Qëndrimet ndaj BE

Pas kundërshtimit irlandez të Traktatit të Lisbonës më parë këtë vit, procesi i zgjerimit u bllokua dhe disa vende anëtare kanë folur hapur kundër pranimit të vendeve të reja deri sa të zgjidhet bllokimi institucional i vetë BE.

Megjithatë, edhe me përjashtimin e dukshëm të Bosnje dhe Hercegovinës, mbështetja për anëtarësimin në vendet e Ballkanit është ende e lartë.

pak (44%).


KROACIA DHE BOSNJA MË SKEPTIKET RRETH BE

SHUMICA E TË PËRGJIGJURVE NDJEHEN TË KEQINFORMUAR RRETH BE

Në shumicën e shteteve të Ballkanit Perëndimor, një shumicë të intervistuarish thanë se nuk mendonin se kishin njohuri të mjaftueshme për BE. Kjo pikëpamje negative ishte veçanërisht e lartë në Mal të Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinë: afërsisht gjashtë në 10 të intervistuar thanë se nuk ishin të informuar rreth BE dhe një në pesë thanë se mendonin se nuk ishin të informuar fare. Vetëm një pakicë prej 35% në Mal të Zi dhe 38% në Bosnje dhe Hercegovinë ndiheshin me njohuri lidhur me BE.

Duke parë përgjigjet ndaj një seri çështjesh rreth BE dhe anëtarësimit përfundimtar të vendeve të Ballkanit, mund të shihet një model i njëtrajtshëm qëndrimesh: ndërsa të intervistuarit nga Kosova dhe Shqipëria dukej se mezi prisnin për anëtarësimin në BE, ata në Bosnje

GJENDJA E NJOHURIVE RRETH BASHKIMIT EVROPIAN



Lutemi çmoni: sa të informuar jeni ju lidhur me Bashkimin Evropian ?

Maqedonia dhe Kroacia ishin përjashtime: në Maqedoni po aq të intervistuar mendonin se ishin të ndërgjegjshëm mjaft rreth BE (50%) dhe që mendonin ndryshe ishin (48%). Në Kroaci, një shumicë ndjehej në fakt e informuar rreth BE (54%), ndërsa ata që mendonin se u mungojnë njohuritë ishin më

dhe Hercegovinë provuan të ishin më të maturit dhe skeptikët ndaj çdo gjëje të etiketuar "BE".

Për shembull, të pyetur nëse anëtarësimi në BE do të ishte gjë e mirë apo e keqe, nëntë

në 10 të intervistuar nga Kosova u përgjigjën pozitivisht dhe disa thanë se ishte ose një gjë e keqe, ose as e mirë e as e keqe (të dy 4%). Në Shqipëri , më tepër se tetë në 10 të intervistuar ishin optimistë rreth anëtarësimit të vendit të tyre në BE (83%) dhe më pak se një në 10 të intervistuar dhanë një përgjigje negative. Ishte vështirë për ndonjë shqiptar të thoshte se anëtarësimi do të ishte një gjë e keqe (2%). Në Bosnje dhe Hercegovinë, megjithatë, vetëm gjysma e të intervistuarve (48%) mendonin se anëtarësimi do të ishte i mirë për vendin e tyre, afërsisht një e treta mendonin se do të ishte as mirë, as keq dhe një në 10 mendonin se do të ishte një gjë e keqe (11%).


Të intervistuarit më të pavendosur rreth anëtarësimit në BE mund të gjendeshin në Kroaci; ajo kishte të intervistuarit më të shumtë që nuk prisnin as rezultat të mirë, as të keq (38%) nga bashkimi i Kroacisë me BE. Pjesa e atyre që shprehën një opinion pozitiv rreth pasojave të mundëshme të anëtarësimit (29%) qe pak më e madhe se ajo e atyre që ishin të bindur se pasojat do të ishin të këqija për vendin (26%).

KOSOVA DHE SHQIPËRIA NDJEHEN TË DËSHIRUAR NGA BE

Ndërsa një shumicë e madhe të intervistuarish në Kosovë dhe Shqipëri ndjehen se Komisioni Evropian e do vendin e tyre të bashkohet me BE, vetëm një pakicë në Kroaci dhe Bosnje dhe Hercegovinë ishin dakord me këtë. Me të vërtetë, tetë në 10 të intervistuar nga Kosova

(82%) dhe dy të tretat e të intervistuarve nga Shqipëria (67%) pranonin se vendi i tyre ishte i mirëpritur në nivelin politik dhe vetëm një pakicë e vogël nuk ishin dakord me këtë (5%

MBËSHTETJA PËR ANËTARËSIMIN NË BE




Folur në përgjithësi, mendoni ju se anëtarësimi [i vendit] në Bashkimin Evropian DO TË ISHTE: një gjë e mirë, një gjë e keqe, apo as e mirë e as e keqe ?

në Kosovë dhe 12% në Shqipëri). Në Kroaci (46%) vetëm pak më shumë se katër në 10 të intervistuar mendonin se Komisioni do të mirëpriste vendin e tyre në BE. Në Republika Sërbska, kjo shifër arrinte vetëm 30%, ndërsa në Federatë ishte 52%. Megjithatë, edhe në qoftë se vetëm një pakicë e të intervistuarve nga këto vende folën pozitivisht, ata prapë ishin më shumë se ata që mendonin se vendi i tyre nuk qe i mirëpritur (Kroacia: 31%, BiH: 38%). Në vendet e tjera, Mali i Zi (57%), Serbia (55%) dhe Maqedonia (53%), një shumicë mendonin se vendi i tyre ishte i mirëpritur në nivelin politik.

Në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor: nga 13% në Kosovë dhe Maqedoni në 29% në Malin e Zi, një numër i rëndësishëm të intervistuarish thjesht nuk ditën ta gjykojnë qëndrimin e Komisionit ndaj vendit të tyre apo refuzuan të përgjigjen.

DATA MË ME GJASË E PRANIMIT NË BE



Këto opinione të ndryshme e pasiguri rreth pranimit në BE u pasqyruan gjithashtu në gjykimin e të intervistuarve rreth qëndrimeve të shtetasve të BE. Përsëri, me përjashtim të Kroacisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës, një shumicë e të intervistuarve mendonin se shtetasit e BE do të pëlqenin që vendi i tyre të hynte në Bashkim. Në këto dy vende, megjithatë, vetëm pak më tepër se katër në 10 të intervistuar kishin këtë pikëpamje (në Bosnje dhe Hercegovinë shifra e përgjithshme ishte 46%, por të intervistuarit në Republika Sërbska, vetëm 30% mendonin se mbështetja e shtetasve të BE ishte me më pak gjasa, më pak se ata në Federatë, 58%, në Kroaci 42% mendonin se do të ishin

të mirëpritur). Një numër i ndjeshëm njerëzish nuk ditën si të gjykojnë qëndrimin e shtetasve të BE ndaj pranimit të vendit të tyre (midis 12% në Maqedoni dhe 30% në Malin e Zi).

Megjithatë, të intervistuarit mendonin se do të ishin pakëz më pak të mirëpritur nga shtetasit e BE se sa nga Komisioni Evropian. Kjo që e vërtetë veçanërisht në Shqipëri ku vetëm 55% e të intervistuarve mendonin se shtetasit e BE do të pëlqenin që vendi i tyre të hynte në Bashkim, krahasuar me dy të tretat (67%) që mendonin se do të ishin të mirëpritur nga Komisioni Evropian. Në Kosovë, po ashtu, të intervistuarit mendonin se shtetasit e BE ishin

më pak të mirëpritur se Komisioni (75% ndaj 82%). Përfundime ndaj kësaj ishin Maqedonia dhe Bosnje dhe Hercegovina, ku pakëz më shumë të intervistuar ndjeheshin të mirëpritur nga njerëzit se sa nga Komisioni (Maqedonia: 57% ndaj 53%; BiH: 46% ndaj 43%).

KROATËT PRESIN TË BASHKOHEN ME BE NË 2013

Kur u pyetën se kur mendonin se vendi i tyre do të bashkohej me BE, të intervistuarit kroatë ishin më optimistët: mesatarisht, ata prisnin që vendi i tyre të bëhej një vend anëtar deri

më 2013. Nga vendet e tjera pas saj, datat mesatare të parashikuara ishin 2015 për Maqedoninë dhe 2018 për Serbinë. Të anketuarit në Shqipëri dhe Kosovë ishin më pak optimistë, pasi ata parashikonin që pranimi të ishte më 2020. Megjithatë, pasiguria rreth datave të ardhshme të pranimi ishte e madhe. Anembanë vendeve, një numër i rëndësishëm të intervistuarish nuk e dinin se kur vendi i tyre do të bëhej një anëtar i BE. Në Malin e Zi, mbi një e treta e të intervistuarve (38%) nuk e dinin apo nuk dhanë përgjigje. Në Maqedoni, nga ana tjetër, njerëzit dukeshin me besim në njohuritë e tyre rreth një date të mundëshme pranimi, pasi vetëm 13% nuk kishin një opinion.

Të kënaqurit dhe besimi në institucionet e rajonit

Opinionet rreth institucioneve të rajonit u shqyrtuan në dy nivele. Të intervistuarve iu kërkua fillimisht të vlerësonin se si kishte punuar qeveria e tyre në tërësi dhe pastaj atyre ju paraqit një listë institucioneve, nga kisha te policia dhe nga qeveria te NATO. Për secilin nga këto institucione, të intervistuarve iu kërkua të thoshin sa shumë besim kanë ata në secilin prej tyre, nga shumë në hiç fare.

TË KËNAQURIT PREJ QEVERIVE: SHFAQET NJË TABLLO E POLARIZUAR


Në pikëpamjet e të intervistuarve lidhur me institucionet e tyre kombëtare kishte dallime të rëndësishme. Ballkani Perëndimor duket të jetë i polarizuar midis qëndrimeve paksa pozitive në shtetet e krijuara rishtazi, si Mali i Zi dhe Kosova dhe një zhgënjimi të dukshëm në Kroaci e Bosnje dhe Hercegovinë.

Me të vërtetë, vetëm Mali i Zi (55%) dhe Kosova (53%) kishin një shumicë të intervistuarish që folën pozitivisht rreth punës së qeverisë së tyre. Të kënaqurit ishin veçanërisht të shumtë në Malin e Zi, ku jo vetëm një e treta e të intervistuarve gjykuan punën e qeverisë të ishte e mirë, por një e katërta bile e konsideroi atë të ishte e shkëlqyer (24%). Vetëm një e treta e të intervistuarve mendonin se puna e qeverisë së tyre ishte e dobët (16%) ose vetëm e mjaftueshme (18%). Në Kosovë, ndërsa shumica e të intervistuarve ishin gjithashtu pozitivë, më shumë prej tyre kishte gjasa ta gjykonin punën si të mirë (39%), se sa si të shkëlqyer (14%). Një e

katërta e të intervistuarve në Kosovë mendonte se qeveria vetëm po bënte një punë të mjaftueshme dhe një në pesë mendonte se puna ishte e dobët (18%).

Në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, një

PERFORMANCA E QEVERIVE NË RAJON




Për secilin nga nivelet pasuese mbi qeverinë, lutemi tregoni sa e mirë [shtë puna që qeveria bën : e shkëlqyer, e mirë, mjaftueshëm apo e dobët].
[VENDI] QEVERIA

numër i ndjeshëm të intervistuarish folën negativisht rreth qeverive të vendeve të tyre. Për shembull, afërsisht katër nga dhjetë shqiptarë (43%) e normuan punën që bënte qeveria e tyre si të dobët. Serbët ishin të ndarë, me një të katërtën (24%) që e gjykonin punën si të mirë dhe një të tretë tjetër (32%) që thoshin se ishte e mjaftueshme. Në Kroaci, pas zgjedhjeve shumë të ngushta, 44% e gjykuan punën

BESIMI NË INSTITUCIONET

■ Shumë ■ Ca ■ Vetëm pak ■ Fare ■ Nuk e di/E pa aplikueshme



e qeverisë të ishte e dobët dhe vetëm 16% mendonin se ishte e mirë apo e shkëlqyer.

Pakënaqësia megjithatë ishte më e madhe në Bosnje dhe Hercegovinë. Dy të tretat e të intervistuarve dhanë notën më të keqe të mundshme, duke thënë se

puna ishte e dobët (67%). Një në pesë gjykan vetëm se ajo ishte e mjaftueshme (21%) dhe vetëm një në 10 thanë se ishte ose e mirë (7%), ose e shkëlqyer (2%). Puna e qeverisë u gjykua të ishte e dobët në pjesën e Federatës me plot 79% dhe u pa me pak dritë më shumë në njësinë serbe, ku 56% e quajtën atë të dobët.

Maqedonia u nda, me 28% të atyre që bazonin në rajonet shqiptare që e gjykonin punën e qeverisë të ishte e mirë apo e shkëlqyer, krahasuar me 56% të pjesës tjetër të vendit.

Për secilin nga institucionet pasuese, lutemi se sa shumë keni besim në to.

BESIM MË I MADH NË ORGANIZATAT FETARE, JO BESIM NË PARTITË POLITIKE

Pjesëmarrësve në sondazh ju paraqit një listë institucionesh si kisha, qeveria, presidenti dhe partitë politike; atyre ju kërkua të thoshin sa shumë besojnë te secila organizatë.

Përgjithësisht, të intervistuarit në Ballkanin Perëndimor nuk shfaqën shumë besim në organizmat politikë të vendeve të tyre. Me të vërtetë, institucionet politikë kombëtarëarritën vetëm një renditje të ulët-të mesme lidhur me besueshmërinë; kisha (dhe organizata

të tjera fetare) dolën në krye pothuajse në të gjitha vendet. Përrjashtime në këtë rregull ishin Kosova dhe Shqipëria: atje, në vend të organizatave fetare, NATO u tha të ishte institucioni më i besueshëm.

Përveç këtij opinioni përgjithësisht të ulët rreth institucioneve politike kombëtare, sondazhi nxorri një polarizim të njohur midis vendeve të Ballkanit Perëndimor: në Malin e Zi dhe Kosovë, të intervistuarit u prirën të kenë më shumë besim në institucionet e ngritura rishtazi, se sa në vendet e tjera të Ballkanit, ndërsa mosbesimi në institucionet politike ishte më i dukshëm në Bosnje dhe Hercegovinë. Me të vërtetë, nëpër Ballkanin Perëndimor, të intervistuarit malazezë kishin më shumë besim në qeverinë (28% kishin shumë besim dhe 35% kishin disi besim). Një tablo e ngjashme u pa në Kosovë ku një shumicë e qartë besonte shumë tek qeveria (22%), apo në një farë shkalle (33%), ndërsa një pakicë kishte vetëm pak (26%) apo nuk kishte fare besim (16%). Në Bosnje dhe Hercegovinë, nga ana tjetër, me zor ndonjë i intervistuar kishte shumë besim në këto institucione (3%) dhe afërsisht një e katërta e të intervistuarve u besonin disi atyre. Shumica e të intervistuarve në vend treguan se ata ose nuk kishin besim fare te qeveria (43%) ose kishin pak besim (23%).

Mosbesimi rreth partive politike në Ballkanin Perëndimor ishte befasues. Me të vërtetë, në shumicën e vendeve, ato ishin institucionet më

të pabesueshme nga të gjitha ato të paraqitura në sondazh. Edhe një herë, ky mosbesim ishte më i dukshëm në Bosnje dhe Hercegovinë, ku vetëm një në dy të intervistuar thanë se ata nuk e besonin fare sistemin e partive. Ishte Kosova që kishte më shumë të intervistuar me besim në partitë politike: vetëm një në gjashtë (16%) thanë se nuk kishin fare besim në sistemin e partive, kurse shumica kishin së paku disi besim në partitë (42%). Megjithatë, Kosova gjithashtu demonstroi më pak besim në partitë politike se sa ndaj ndonjë institucioni tjetër në listë.

Një rezultat i dukshëm i sondazhit ishte niveli shumë i ulët i besimit në sistemin gjyqësor në shumicën e vendeve në rajon. Së paku "pak" nivel besimi në gjykatat është një kërkesë bazë e një shoqërie që funksionon mirë, por kjo mungon në shumicën e vendeve këtu. Kroacia po përjeton një krizë, me vetëm një të katërtën e njerëzve që thonë se kishin ose shumë (5%), ose disi (20%) besim në gjykatat. Nga ana e ndritshme, megjithatë, në Bosnje dhe Hercegovinë, të intervistuarit vunë gjykatat midis pesë institucioneve më të besuara.

Ushtria ishte organizata më e besuar pas institucioneve fetare në Serbi, Kroaci, Maqedoni dhe Bosnje dhe Hercegovinë. Në Kosovë, ushtria u rendit e dyta pas NATO-s, duke pasqyruar rolin që këto institucione kanë luajtur në historinë e kohëve të fundit të rajonit.

Qeverisja e mirë dhe korrupsioni

Prishja e Jugosllavisë në fillim të viteve 1990 dhe luftrat që pasuan kanë lënë një peshë të rëndë mbi njerëzit: zhvillimin e rrjeteve të forta kriminale dhe lindjen e një sektori “gri” të ekonomisë. Sot, “mafiat” e ndryshme që operojnë në rajon kanë reputacionin e të qenit nga më të fortat në Evropë dhe disa nga më të vështirat për t’u prishur.

Si rrjedhim, nivelet më të larta të korrupsionit dhe kriminimit të organizuar janë theksuar si disa nga problemet kryesore në Ballkanin Perëndimor dhe si çështje që janë vështirë të shrrënjosen. Disa vëzhgues mendojnë se fenomenet janë rrënjësor aq thellë sa që tani ato shihen si një mënyrë jete.


Shqyrtimi nga Monitori i Ballkanit i Gallupit i qëndrimeve të njerëzve ndaj korrupsionit tregoi se ai nuk pranohej nga shumica; megjithatë, rezultatet ndryshonin në vende të ndryshme dhe vareshin nga tipi i korrupsionit që shqyrtohej. Sondazhi theksoi gjithashtu pakënaqësinë e përgjithshme të të intervistuarve me zhvillimin e vendeve të tyre, pasqyruar nga qëndrimet e tyre negative ndaj politikës dhe mënyrës se si ata janë qeverisur.

NIVELET E RAPORTUARA TË RRYSHFETIT TË ULTA, ME PËRJASHTIM TË SHQIPËRISË

Rezultatet e sondazhit treguan se korrupsioni shihej si një problem anembanë të gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Për shembull,

nga 79% E të intervistuarve në Malin e Zi, në 94% të atyre në Maqedoni, thanë se korrupsioni duhet të eliminohet me qëllim që të stabilizohet rajoni dhe të lehtësohet zhvillimi i ardhshëm. Megjithatë, me përjashtim të Shqipërisë, nivelet e rryshfetit midis zyrtarëve qeveritarë dhe punonjësve civilë që ishin raportuar në fakt nuk ishin shumë të lartë. Me të vërtetë, në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor, një në

PËRVOJA E TË DHËNIT TË NJË RRYSHFETI NË 12 MUAJT E FUNDIT



Gjatë viti të kaluar, ju ka kërkuar apo ka pritur prej jush t'i jepni bakshish për shërbimin e tij ndonjë zyrtar qeveritar apo punonjës civil në [Vend]?

10 apo më pak të intervistuar thanë se i kishin ofruar rryshfet një zyrtari qeveritar apo punonjësi civil. Në Shqipëri, gjithsesi, një e treta e të intervistuarve kishin përjetuar një korrupsion të tillë (32%).

Zyrtarët që kërkonin një rryshfet ishin më shpesh të raportuar të ishin policë apo personel nga shërbimet mjekësore. Në Serbi, për shembull, më tepër se gjysma e të gjithë rryshfeteve u paguhen policëve (54%), kurse ky ishte kryesisht rasti për mjekët dhe infermieret në Shqipëri (50%).

MBËSHTETJA PËR TË PËRDORUR NDIKIMIN E NJOHJEVE PËR TË PËRFITUAR KUJDES MË TË MIRË SPITALOR


Shumë të intervistuar në vendet e Ballkanit Perëndimor mendonin se korrupsioni ishte i pa-pranueshëm. Me të vërtetë, të pyetur nëse ishte e drejtë apo jo të përdorje njohjet apo të ofroje nxitje për të kryer gjërat (domethënë të kërkoje ndikimin e lidhjeve, të jepje dhurata të vogla apo të ofroje para me qëllim që të gjeje kujdes më të mirë në spital, t'u siguroje fëmijëve pranim në një shkollë më të mirë, të shmangie pagesën e gjobave të trafikut apo të gjeje një kontratë qeveritare përfituese për një biznes të vogël), në shumicën e skenarëve vetëm një pakicë nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhanë miratimin e tyre.

Në Malin e Zi, megjithatë, kishte më shumë pranim të këtyre praktikave të diskutueshme me qëllim që të bësh punët. Kërkimi i ndihmës së lidhjeve dukej të ishte mjaft i zakonshëm atje (për shembull, ky ishte vendi i vetëm ku një shumicë favorizoi një metodë të tillë, 53%).

Në përgjithësi, përdorimi i ndikimit të lidhjeve shihej të ishte shumë më i pranueshëm se sa praktika e ofrimit të peshqesheve të vogla apo dhënies së parave. Për shembull, me qëllim që të gjenin kujdes më të mirë në spital, pothuajse katër herë më shumë të intervistuar kroatë do të përpiqeshin të përdornin ndikimin e lidhjeve, se sa ata që do të ofronin para shtesë për këtë qëllim (44% ndaj 12%).

QEVERITË DUHET TË BËJNË MË SHUMË PËR TË LUFTUAR KRIMIN E ORGANIZUAR

ME QËLLIM TË KUJDESIT MË TË MIRË NË SPITAL, ËSHTË E PRANUESHME



Çfar do të thoshit: me qëllim që të kesh kujdes më të mirë në spital, është e pranueshme...
% e pranueshme


Anëmbanë të gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor, vetëm një pakicë të intervistuarish mendonin se qeveria e tyre kishte bërë mjaft për të luftuar krimin e organizuar. Maqedonia ishte një përjashtim, duke qënë i vetmi vend ku të intervistuarit mbështetës ishin më të shumtë në numër se ata që mendonin se kishte përpjekje të pamjaftueshme për të luftuar krimin e organizuar (49% ndaj 35%). Në Malin e Zi (45%), Kosovë (48%) dhe Shqipëri (48%), gati gjysmës së të intervistuarve nuk u bënin përshtypje përpjekjet e qeverive të tyre për

të trajtuar krimin e organizuar me efektshmëri dhe vetëm një pakicë prej afërsisht tre në 10 në Shqipëri (29%), një e treta në Kosovë (32%) dhe një në katër (38%) në Malin e Zi ishin të bindur nga veprimet e qeverisë së tyre.

Ndërsa në Serbi, vetëm një e katërta e të intervistuarve mendonin se kishte vendosmëri të mjaftueshme për të luftuar krimin e organizuar (kundrejt gjashtë në 10 që nuk ishin dakord), të intervistuarit nga Bosnje dhe Hercegovina dhe Kroacia ishin përsëri më kritikë rreth veprimeve të qeverive të tyre: rreth tre të katërtat bënë fajtorë qeverinë dhe vetëm një në 10 i konsideronte veprimet të ishin të mjaftueshme (të dyja 12%).

Anëmbanë të gjitha vendeve të Ballkanit

A PO BËN QEVERIA MJAFT PËR TË LUFTUAR KRIMIN E ORGANIZUAR?



Do të ishit ju dakord se qeveria po bën gjithëshka që ka në dorë për të luftuar krimin e organizuar?

Perëndimor, një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve nuk dinin si të përgjigjeshin ose refuzuan të përgjigjen kur u pyetën për të gjykuar veprimet e qeverisë ndaj krimin të organizuar. Ky ishte më shpesh rasti në Shqipëri (23%) dhe Kosovë (20%).

Migracioni dhe lëvizshmëria


Sot, me lirinë e njerëzve të rajonit për të udhëtuar të kufizuar edhe më shumë seç ishte në rregjimet komuniste, migracioni është një nga çështjet kyçe të rajonit. Ndonse shtetasit e tij shpesh shprehin irritimin e tyre ndaj vështirësisë për të marrë vizat e për të udhëtuar jashtë shtetit, ka disa shenja se situata po ndryshon.

Sot vëzhguesit thonë se marrëveshjet e lehtësimit të vizave, që shumica e vendeve ka nënshkruar tashmë me BE, nuk kanë dhënë ende rezultatet e shpresuara dhe se zbatimimi i tyre është disi me defekte. Rrjedhimisht, një numër i ndjeshëm të intervistuarish në Monitorin e Ballkanit të Gallupit, kanë identifikuar liberalizimin e vizave dhe rregullave të udhëtimit si midis çështjeve ku komuniteti ndërkombëtar mund të ndihmonte shumë.

Një pjesë e rëndësishme e pjesëmarrësve besonin gjithashtu se ata mund të gjenin mundësi më të mira për të realizuar potencialin e tyre jashtë shtetit, ndonse shumë do të preferonin të mos linin vendin e tyre përgjithmonë.

në lehtësimin e rregullave të udhëtimit e vizave do të ishte më e mirëpritur nga shqiptarët: mbi gjysma e të intervistuarve donin që komuniteti ndërkombëtar të ndihmonte në këtë fushë (56%). Ata nuk ishin vetëm megjithatë, pasi kërkesa të ngjashme u bënë nga katër në

OPINIONET LIDHUR ME LËVIZJEN NË NJË VEND TJETËR



Si ide, do t'ju pëlqente të lëvizni (përkohësisht apo përgjithmonë) në një vend tjetër apo do të preferonit të vazhdonit të jetoni në [Vendin/Njësinë] tuaj?

NJË KËRKESË QË TË HIQEN KUFIZIMET E UDHËTIMIT DHE VIZAVE

Kur Monitori i Ballkanit i pyeti pjesëmarrësit se si e mendonin që komuniteti ndërkombëtar mund të ndihmonte më mirë Ballkanin Perëndimor, të intervistuarit në shumë vende kërkuan një lehtësim të kufizimeve të udhëtimit dhe vizave.

Një ndihmë e tillë e komunitetit ndërkombëtar

10 të intervistuar nga Bosnje dhe Herzegovina (45%) dhe Maqedonia (41%) dhe nga afërsisht një e treta e të intervistuarve nga Mali i Zi (35%) dhe Kosova (30%). Nevoja për të lehtësuar kufizimet e udhëtimit e vizave ishte më pak e ngutshme në Serbi (21%) dhe Kroaci (16%).

SHUMICA E TË PËRGJIGJURVE SHOHIN PERSPEKTIVA MË TË MIRA JASHTË

Në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, një shumicë e të intervistuarve mendonin se njerëzit kishin mundësi më të mira jashtë vendit të tyre. Mali i Zi dhe Kroacia ishin përjashtime, pasi afërsisht gjysma e të intervistuarve dhanë një vlerësim pozitiv të mundësive ekzistuese në atdhe.

Në Kosovë, njerëzit ishin veçanërisht lakmtarë për mundësitë jashtë: më tepër se shtatë në 10 të intervistuar mendonin kështu dhe një në pesë mendonin se mundësitë ishin po aq, ose edhe më të mira në vendin e tyre. Në Shqipëri, dy të tretat e të intervistuarve vlerësuan mundësitë në vendet e tjera të ishin më të mira se ato në atdhe dhe vetëm një e treta nuk qe dakord me këtë.


Të intervistuarit në Kroaci (64%) dhe Malin e Zi (54%) ishin më me gjasë të shihnin mundësi në vendet e tyre. Vetëm një pakicë prej katër në 10 të intervistuar në Malin e Zi (38%) dhe tre në 10 në Kroaci (31%) shihnin më shumë shanse përtej kufijve të vendit të tyre se sa brenda.

Duke vështruar Ballkanin Perëndimor në tërësi, afërsisht një në 10 të intervistuar apo më pak, mendonin se vendi i tyre do të ofronte shanse më të mira se çdo vend tjetër në botë.

Të pyetur nëse do të preferonin të lëviznin në një vend tjetër apo të qëndronin në vendin e tyre, një shumicë prej shtatë në 10 apo më shumë të intervistuar anembanë vendeve të Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Shqipërisë, thanë se do të donin të vazhdonin të jetonin në vendin e tyre. Megjithatë një pakicë e konsiderueshme deklaroi gatishmëri të vet për të lënë vendin. Kroatët (7%) ishin

të fundit e mundshëm për të thënë se do të donin të lëviznin në një vend tjetër. Në Kosovë, një në shtatë (15%) ishin gati të iknin dhe në Malin e Zi (20%), Bosnje dhe Hercegovinë

PJESA E TË PËRGJIGJURVE ME NJË ANËTAR TË FAMILJES JASHTË



Ka shkuar ndonjë nga familja juaj pë të punuar a studjuar përkohësisht në një vend tjetër?
% po

(21%) dhe Serbi (22%) rreth një në pesë të intervistuar ishin gati të përgatitnin plaçkat. Në Maqedoni, ky përpjestim madje arriti në një në katër (25%). Shqiptarët ishin me të vërtetë të intervistuarit më të gatshëm të iknin e të jetonin jashtë pasi vetëm gjysma e të intervistuarve preferonte të vazhonte të jetonte në Shqipëri ndërsa një e treta ishin gati të lëviznin në një vend tjetër. Në Shqipëri dhe Kosovë, dy të tretat e njerëzve bile mendonin se ata që shkonin të jetonin përkohësisht apo përgjithmonë në një vend tjetër ishin një "ndihmë e madhe për vendin". Me përjashtim të të intervistuarve në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Malin e Zi, shumica e atyre të intervistuarve që thanë se do të donin të lëviznin në një vend tjetër, thanë gjithashtu se preferonin të ktheheshin në atdheun e tyre një ditë. Të intervistuarit nga Kosova dhe Maqedonia që kishin deklaruar gatishmëri të tyre për të ikur, parashikuan qëndrime të përkohëshme (70% dhe 67% respektivisht). Vetëm një e katërta (27%) e atyre në Kosovë dhe 31% në Maqedoni kishin plane përfundimtare për të emigruar.

Të intervistuarit në Malin e Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinë ishin më me gjasa të mendonin rreth emigrimit përgjithëmonë. Në këtë të fundit, një shumicë e të intervistuarve donte të rrinte jashtë përherë (52%), ndërsa vetëm 44% planifikonin të ktheheshin. Në Malin e Zi afërsisht një në dy të intervistuar kishin emigracionin e përhershëm në mend dhe 48% donin që të ktheheshin në atdheun e tyre në një kohë në të ardhmen.

LËVIZSHMËRI E LARTË: MBI NJË E PESTA KANË NJË ANËTAR FAMILJEJE JASHTË

Anëmbanë shumicës së vendeve të Ballkanit Perëndimor, midis një të pestës (Serbia: 18%) dhe një të katërtës të të intervistuarve (Mali i Zi : 26%) thanë se kanë një anëtar familjeje që punon apo studjon jashtë.

Mes të intervistuarve që thanë se një anëtar i familjeve të tyre kishte lënë vendin për punë apo studime (42%), shqiptarët kryesojnë përsëri këtu. Megjithatë, ishin gjithashtu një në tre të intervistuar kosovarë që kishin një anëtar familjeje jashtë.

Rezultatet treguan se kushtet ekonomike ishin një nga arsyt kryesore për njerëzit në Shqipëri e Kosovë për të punuar jashtë kufijve të tyre. Me të vërtetë, nga të intervistuarit në këto dy vende që thanë se kanë një anëtar të familjes jashtë vendit, tetë nga 10 thanë se ky person jepte ndihmë financiare. Në Maqedoni dhe BiH ndonse një shumicë thoshte se kishin marrë ndihmë financiare nga anëtarët e familjes jashtë, ata nuk kishin gjasa të thoshin se ky ishte rasti (59% dhe 52% respektivisht). Në Serbi, një ndihmë e tillë financiare ishte më e pazakontë (31%).

Sfidat e Ballkanit: Kosova, stabiliteti i ardhshëm i rajonit dhe ICTY

Pavarësisht nga kundërshtimi i fortë i Beogradit dhe refuzimi i tij kategorik për të njohur shtetin e ri, shpërbërja e Jugosllavisë u kompletua në krye të viti të kaluar kur Kosova shpalli pavarësinë. Megjithë paralajmërimet rreth ndikimit të mundshëm në stabilitetin e rajonit që paraprinë shpalljen e njëanëshme të pavarësisë dhe me disa përjashtime protestash të dhunshme në javët që pasuan ngjarjen, Ballkani nuk u trondit thellë nga krijimi i këtij shteti të ri.


Megjithatë, pikëpamja e vendeve të ndryshme mbi çështjen ndryshon, me një shumicë dërmuese të të intervistuarve nga Kosova dhe Shqipëria që thonë se pavarësia ka patur një ndikim pozitiv në rajon, por vetëm me një pakicë pjesëmarrësish serbë e malazezë në sondazh që kanë këtë qëndrim.

Pas një numri verdimesh të fundit të konsideruara të debatueshme në disa vende të Ballkanit, pikëpamja e të intervistuarve rreth Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (ICTY) gjithashtu varionte nëpër rajon; vetëm të intervistuarit shqiptarë e kosovarë shprehën një opinion të qartë pozitiv rreth rolit të gjykatës.

Serbia nga ana tjetër.

Ndërsa një pjesë e madhe e të intervistuarve në Shqipëri e Kosovë ishin të bindur rreth ndikimit pozitiv të një Kosove të pavarur në sta-

NDIKIMI I KOSOVËS SË PAVARUR NË STABILITETIN E RAJONIT



PAVARËSIA E KOSOVËS: NJË NDARJE E DALLUESHME PËR REZULTATIN

Rezultatet e Monitorit të Ballkanit pasqyruan polarizimin në qëndrimet ndaj shpalljes së pavarësisë nga Kosova, midis të intervistuarve nga Kosova dhe Shqipëria nga njëra anë dhe

ilitetin e rajonit (92% dhe 89% respektivisht), të intervistuarit në Serbi dukshëm mbanin një këndvështrim të kundërt (74% negativ). Pak njerëz ishin kundër pikëpamjeve të shumicës: në Shqipëri në veçanti, me zor kishte ndonjë të intervistuar që mendonte se Kosova e pavarur mund të kishte një ndikim negativ (2%, 7%

në Kosovë). Në Serbi, vetëm pak njerëz (8%) mendonin se pavarësia e Kosovës ishte pozitive për stabilitetin e Ballkanit.

Në vendet e tjera, pikëpamjet ishin më të ndara: pavarësia e Kosovës shihej më negativisht në Maqedoni, BiH dhe Malin e Zi (44% - 47% kishin të tillë pikpamje), ndërsa Kroacia kishte të intervistuarit më pozitivë (38% ndaj 30% negativë). Megjithatë, midis 29% dhe 36% e të intervistuarve në Kroaci, BiH dhe Malin e Zi nuk dhanë opinion mbi çështjen. Në BiH, pikëpamjet ndaheshin thellësisht sipas vijave etnike: në Republika Sërbska, 69% shihnin pasojë negative, ndërsa në Federatë vetëm 28% mendonin kështu. Po ashtu në Maqedoni, kjo ishte një nga çështjet më të ndara, me vetëm 9% të shqiptarëve që nuk shihnin ndonjë pasojë negative, ndërsa dy të tretat (67%) e pjesës tjetër të vendit ishin të shqetësuar rreth pasojave.

SERBËT E KOSOVËS NUK SHOHIN BASHKË-EKZISTENCË ME SHQIPTARËT E KOSOVËS


Përafërsisht shtatë në 10 shqiptarë të Kosovës mendonin se jetesa së bashku në paqe me serbët e Kosovës ishte e mundshme (kundrejt një në pesë që nuk ishin dakord). Shumica e serbëve, megjithatë, nuk ishin dakord se që e mundur jetesa së bashku në paqe me shqiptarët e Kosovës. Më pak se një në pesë të intervistuar nga serbët e Kosovës pranuan se bashkë-ekzistenca paqësore ishte e mundur (17%). Serbët e Kosovës ishin më me gjasë të thoshin se nuk e dinin ose refuzuan të

përgjigjen (28%, kundrejt 9% të shqiptarëve të Kosovës).

SHUMICA E SERBËVE MENDOJNË SE QEVERIA E TYRE NUK DO TA NJOHË KURRË KOSOVËN

Të intervistuarit në Serbi u pyetën se kur mendonin se qeveria e vendit të tyre do ta njihje shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

MUNDËSIA PËR TË RROJTUR BASHKË NË MËNYRË PAQËSORE NË KOSOVË ME...



Një shumicë prej gjashtë nga 10 të intervistuar mendonin se kjo nuk do të ndodhte kurrë. Vetëm një grup i vogël prisnin njohjen e menjëhershme (5%), ndërsa një në pesë mendonin se kjo do të ishte brenda pesë deri dhjetë vjetëve. Një në shtatë serbë (15%) nuk e dinin apo refuzuan të përgjigjen se kur qeveria e tyre do të pranonte pavarësinë e Kosovës.

Tetë në dhjetë të intervistuar në Serbi mendonin se krenaria e vendit ishte dëmtuar nga shpallja e Kosovës dhe shtatë në 10 mendonin se Kosova duhet të mbetet pjesë e Serbisë. Megjithatë, gati dy të tretat e të

intervistuarve ishin kundër idesë se si mjet i fundit shkëputja duhej të pengohej me armë (64%), një ide që mbështetej nga një në pesë serbë (22%).

Megjithatë, pak më shumë se gjysma e të intervistuarve ishin të opinionit se njerëzit në Kosovë duhet të kishin të drejtën të vendosnin rreth pavarësisë së tyre (54%) dhe se Kosova do të ishte e pavarur gjithsesi, pavarësisht nga çfarëdo veprimi që Serbia mund të merrte.

Vetëm një e treta e të intervistuarve në Serbi mendonin se Kosova do t'i përkiste Shqipërisë një ditë (29%), ndërsa gati gjysma e të intervistuarve as që mund ta imagjinonin këtë skenar (45%).


MAQEDONASIT DHE SERBËT NUK JANË TË BINDUR SE RREZIKU I LUFTËS KA KALUAR

Rreth një në katër serbë dhe maqedonas (22% dhe 29% respektivisht) mendonin se mund të kishte një tjetër luftë në rajon. Megjithatë, pavarësisht nga këto pikëpamje, një shumicë e madhe të intervistuarish anembanë vendeve të Ballkanit Perëndimor mendonin se në pesë vitet e ardhshëm nuk do të kishte konflikt të armatosur në rajon.

Të intervistuarit nga Kosova ishin veçanërisht optimistë se e ardhmja e afërt e Ballkanit do të ishte paqësore. Tetë në 10 e të intervistuarve mendonin se nuk do të kishte luftë të ardhshme rajonale dhe gati gjysma bile mendonin se me siguri nuk kishte rrezik të një konflikti të armatosur në pesë vitet e ardhshëm (45%). Vetëm

një në 10 të intervistuar parashikonin konflikte të armatosura të ardhshme. Më tepër se tre të katërtat e të intervistuarve në Shqipëri (75%), Bosnje dhe Hercegovinë (76%) dhe Kroaci (79%) ishin optimistë rreth stabilitetit të rajonit dhe vetëm pak më shumë se një në 10 para-

SHANSI I NJË KONFLIKTI TË ARMATOSUR NË BALLKAN



Duke parë në pesë vjetët e ardhshme, mendoni ju se do të ketë një shans për konflikt të armatosur diku në Ballkan?

shikonin konflikte të armatosur në të ardhmen e afërt. Në Malin e Zi (66%), Maqedoni (64%) dhe Serbi (61%), një shumicë prej afërsisht dy të tretat besonin se do të kishte stabilitet.

Në Malin e Zi dhe Serbi, afërsisht një në pesë të intervistuar nuk e dinin nëse kishte një rrezik lufte gjatë pesë viteve të ardhshëm. Në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, afërsisht një në 10 të intervistuar nuk e dinin apo nuk u përgjigjën.

OPINIONI PUBLIK I NDARË RRETH ROLIT TË ICTY


Të intervistuarit u ndanë rreth asaj nëse Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (ICTY) luajti një rol pozitiv apo negativ në Ballkanin Perëndimor. Në Shqipëri (69%) dhe

Kosovë (68%) afërsisht shtatë në 10 të intervistuar mendonin se gjykata kishte ndihmuar pajtimin dhe forcimin e paqes, ndërsa vetëm një pakicë e vogël prej 12% në Shqipëri dhe 17% në Kosovë nuk ishin dakord.

Në Maqedoni (52%), Kroaci (53%) dhe më e rëndësishme, në Serbi (64%), një shumicë e të intervistuarve mendonin se ICTY nuk u shërbeu interesave të rajonit dhe thjesht kishte ushqyer konfliktet e kaluara. Kroacia dhe Serbia ishin vendet që ishin më pak mbështetëse të pikëpamjes se gjykata kishte ndihmuar paqen dhe pajtimin.

Në Malin e Zi, megjithatë kishte më shumë opinione negative rreth gjykatës (42% kundrejt 36% pozitive) dhe në Bosnje dhe Hercegovinë, pikëpamjet ndaheshin midis atyre që jetonin në Republika Sërbska dhe në Federatë (9% dhe 61% respektivisht, duke e parë gjykatën se


ROLI I ICTY NË TË ARDHMEN E RAJONIT



Në pikëpamjen tuaj cili është roli që ICTY luan në të ardhmen e rajonit?

e treta e njerëzve në secilin vend, besonin se procedimet e ICTY ishin të pa-anëshme dhe përfundimet ishin të hapura.

KARAXHIÇ: I PAFAJSHËM APO FAJTOR PËR KRIMET E LUFTË



Cili është më pranë opinionit tuaj?

**KARAXHIÇ: OPINIONI PUBLIK
SERB I POLARIZUAR**

Efekti i polarizimit të çështjes së krimeve të luftës është ilustruar më mirë nga qëndrimet e serbëve mbi Radovan Karaxhiçin e arrestuar së fundmi: të intervistuarit ishin tepër të ndarë me pothuajse një të katërtën që e shihnin atë si fajtor, një shumicë relative e pothuajse gjysmës (47%) që mendonin se ishte i pafajshëm dhe pothuajse një e treta, që ishin të pavendosur. Megjithatë, 45% ishin dakord se arrestimi i tij ishte i mirë për të ardhmen e Serbisë dhe 53% besonin se kjo ishte e mirë për procesin e integritetit të Serbisë në BE. Më shumë njerëz ishin dakord se sa nuk ishin dakord me pohimin (49% kundrejt 32%) se arrestimi i tij e lejoi Serbinë të përqëndrohej në të ardhmen.

ndihmoi pajtimin dhe forcimin e paqes). Të pyetur rreth pa-anshmërisë së ICTY, me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës, më pak se një

Përfundime

Ballkani Perëndimor është një rajon i shumëllojtë, i vendosur midis rritjes e erësimit, midis krizës dhe krijimit. Monitori i Ballkanit i Gallupit pasqyron këtë diversitet në paraqitjen e një tabloje të përzjerë të Ballkanit Perëndimor të sotëm. Ndonse shumë nga të intervistuarit ishin të kënaqur me jetën e tyre, ata gjithashtu shprehnin një shqetësim se vendet e tyre nuk po zhvilloheshin ashtu siç duhej apo siç mundeshin. Kjo shpinte në shumë të intervistuar të thoshin se mundësitë më të mira mund të gjendeshin ende jashtë vendit.

Duket se kishte një polarizim të qartë midis vendeve më të reja të rajonit, Kosova dhe Mali i Zi, që janë tepër optimistë për të ardhmen dhe vendeve të tjera, që janë shumë më pak pozitivë. Megjithatë, do të ishte me interes të shihej se sa gjatë zgjat kjo periudhë e 'muajit të mjaltit' dhe se si do të zhvillohet në vitet që vijin. Në rastin e Kosovës, në veçanti, shumë analistë kanë paralajmëruar rreth ekonomisë së brishtë të shtetit të ri. Përveç kësaj, refuzimi kategorik i Serbisë për të njohur pavarësinë e ish-krahinës, pasqyruar nga rezultatet e Monitorit Ballkanik, ka gjasë të pengojnë disa aspekte të zhvillimit të ardhshëm të Kosovës.

Sondazhi nënvizoi gjithashtu nevojën për politikanët e rajonit për të dhënë rezultate më të mira për zgjedhësit e tyre në shumë aspekte të jetës. Për shembull, ndonse korrupsioni dhe krimi i organizuar janë njohur të jenë si pengesat më të mëdha në zhvillimin e rajonit, ka një ndjesi të përgjithëshme të bezdisë rreth mosveprimeve të qeverive.

Megjithatë, më tepër se një dekadë pas fundit të luftrave të Ballkanit, rajoni duket të ketë fituar një farë stabiliteti me vetëm një pakicë të të intervistuarve që besonin se një konflikt i ri i armatosur mund të ndodhte në vitet që vijin. Sidoqoftë, rreth një në katër serbë dhe maqedonas (22% dhe 29% respektivisht)

mendonin se mund të kishte një tjetër konflikt. Në të njëjtën kohë, në shumë vende, me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës, të intervistuarit kanë mbetur skeptikë rreth rolit të pavarësisë së Kosovës në sjelljen e paqes dhe pajtimit në rajon.

Sot, vendet e Ballkanit Perëndimor po lëvizin përpara në anëtarësimin e plotë përfundimtar të BE dhe mbështetja për këtë proces mbetet e lartë. Lidhur me këtë, shtetasit e rajonit kanë miratuar një qëndrim disi realist ndaj pranimit në BE, me vetëm një pakicë të të intervistuarve në të gjitha vendet që imagjinojnë se vendi i tyre do të bëhet anëtar i plotë i BE në pak vitet e ardhëshme. Opinionet rreth asaj se si do të priten vendet e Ballkanit Perëndimor, janë të përzjera me të intervistuarit që mendojnë se Komisioni Evropian do të ofronte një mirëpritje më të ngrohtë se sa vetë shtetasit e BE.

Objektivi i Monitorit të Ballkanit ishte të mbulonte një sferë sa më të gjerë çështjesh me qëllim që të tregonte një tablo realiste dhe aq të duhur të Ballkanit Perëndimor ... të parë nga brenda. Ky raport është vetëm një paraqitje e shkurtër e sondazhit të plotë: faqja shoqëruese në internet (shih www.balkan-monitor.eu) do të përmbajë një tërësi mjetesh që lejojnë shqyrtimin e mëtejshëm të të dhënave. Në një rajon të tillë tejet dinamik ka gjasë të ndodhin

shumë ndryshime në vitet që vijnë. Këto do të jenë në peisazhin politik, social dhe ekonomik të vendeve të interesuara, si dhe në opinionin publik në terren. Ato do të jenë shumë me vlerë

të ndiqen, ndërsa i afrohem sondazhit tjetër të Monitorit të Ballkanit të Gallupit më 2009.

Rreth Fondit

SJELLJA E BALLKANIT PERËNDIMOR MË PRANË BASHKIMIT EUROPIAN

Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët shumë-vjeçare e fondacioneve që përfshijnë Robert Bosch Stiftung, King Baudouin Foundation, Compagnia di San Paolo dhe ERSTE Foundation.

Fondi është ndërtuar për të ndërmarrë dhe mbështetur nisma që kanë për qëllim sjelljen e Ballkanit Perëndimor më pranë Bashkimit Evropian nëpërmjet programeve operacionale dhe të dhënies së financimeve; si i tillë, ai është përqëndruar te individët dhe organizatat nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Si një veprimtari e drejtpërdrejtë pasuese e Komisionit Ndërkombëtar mbi Ballkanin (2004-2006), Fondi mishëron “Strategjinë e Ndërtimit të Shteteve Anëtare të BE” me përparësitë e veta të përqëndruara në zhvillimin e administratave të shteteve funksionuese dhe ndërtimit të zonave zgjedhore.

Fondi u krijua më 2007 me sekretariatit në Beograd. Nisma iu paraqit rajonit në një fillim publik në Sarajevë, në qershor 2008.

OBJEKTIVAT

Objektivat e Fondit janë:

- të inkurajojë angazhimin e gjerë e të fortë në integrimin evropian të vendeve dhe shoqërive të Ballkanit Perëndimor;
- të forcojë përpjekjet e ndërmarrë nga një rang i atyre që mbajnë peshën në këtë proces, me një synim për të zhvilluar politikat

dhe praktikat efektive në rajon dhe në BE;

- të mbështesë procesin e ndërtimit të vendeve anëtare siç parashikohet nga Komisioni Ndërkombëtar mbi Ballkanin, në veçanti duke ndërtuar grupet që u shërbehet në shoqëritë e Europës Juglindore që do t’u ofrohet një mundësi për të fituar përvojë nga Europa dhe BE dhe për të mësuar rreth tyre.

PROGRAMET

Për të ndjekur objektivat e tij, Fondi zhvillon programet funksionale dhe të dhënies së financimeve në katër fusha kryesore:

1. Shqyrtimi i Europës

Mbështetja e projekteve të kërkimit dhe zhvillimit të politikave si dhe të nismave të përhapjes së medias.

2. Ushtrimi i Europës

Zgjerimi i aftësive profesionale dhe administrative i zyrtarëve të rinj qeveritarë të Ballkanit në procesin e integritit në BE.

3. Përvoja e Europës

Mundësimi i brezave të rinj në Ballkanin Perëndimor të fitojnë përvojë nga Europa dhe BE dhe të mësojnë rreth tyre.

4. Zhvillimi i politikave për Ballkanin

Zgjerimi i imazhit publik të Fondit dhe kontributit të tij në bërjen e politikës për integrimin në BE të Ballkanit nëpërmjet nismave të përbashkëta dhe partneriteteve.

PARTNERITETI PUBLIK PRIVAT

Fondi është i hapur ndaj donatorëve të tjerë privatë e publikë dhe është ndërtuar të angazhojë jo vetëm dhënësit e fondeve tashmë aktive në Ballkan, por gjithashtu dhuruesit publikë e privatë që nuk kanë punuar në rajon deri tani apo që duan të ngrenë fondet e tyre dhe të rritin ndikimin e tyre.

Fondi aktualisht mbahet nga Rrjeti i Fondacioneve Europiane - NEF (Bruksel) që

jep asistencën ligjore e administrative.

KONTAKTI

FONDI EUROPIAN PËR BALLKANIN

Resavska 35

11000 Belgrade

Serbia

Tel: +381.0.11.30.33.662

info@balkanfund.org

www.balkanfund.org

Rreth Gallupit

BURIMI I PARË I BESUAR NË KUPTIMIN SE SI SHTETASIT MENDOJNË E NDJEJNË

Për më tepër se 70 vjet Gallup ka ndërtuar reputacionin e tij mbi dhënien e studimeve të duhura, në kohë dhe parashikuese mbi atë që njerëzit anembanë botës mendojnë e ndjejnë. Duke shqyrtuar opinionet e qëndrimet e shtetasve, Gallup ndihmon vendim-marrësit të formojnë axhendat e tyre.

Si një pionier në studimet e aplikuara sociale, Gallup vlerëson ndërgjegjësimin e shtetasve dhe qëndrimet ndaj çështjeve sociale, politike dhe ekonomike. Gallup është bërë gjithashtu një kampion në vlerësimin e ndikimit të politikave, shërbimeve dhe fushatave të mediave në të gjitha fushat.

GALLUPI NË VEPRIM

Zyra e Gallupit në Bruksel bashkërendon veprimtaritë anketuese në Europë, duke përdorur personel nga e gjithë Organizata Gallup në të gjithë botën. Duke ofruar të gjitha teknikat standarde të anketimit, zgjidhjet e porositura të Gallup mund të bashkëplotësohen nga analiza të thella statistikore dhe mjetet më të përparura të paraqitjes vizive të të dhënave.

Si ofruer i Flash Eurobarometer, të Komisionit, Gallup kryen mbi 400,000 intervista në vit, që shkojnë nga sipërmarrja e punësimit e deri te arsimit dhe nga vlerat evropiane te sfidat globale.

Gallup beson se mbledhja e ndarja e informacionit është një pjesë jetike e krijimit të politikës dhe një hap i rëndësishëm në forcimin e shtetasve.

DHËNIA E KUPTIMIT OPINIONEVE DHE NDJESIVE

KONTAKTI

Gallup
Avenue Michel-Ange 70
1000 Brussels
Belgium
Tel: +32.2.734.54.18
contact@gallup-europe.be
www.gallup-europe.be | www.gallup.com

GALLUP®

Balkan Monitor

Insights and Perceptions: Voices of the Balkans

in partnership with the

European Fund for the Balkans